

Ambasadorja e Kinës vizitë në KMSHC

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), priti në një takim zyrtar Ambasadoren e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, znj. Pang Chunxue.



Gjatë këtij takimi u prezantua veprimtaria e KMSHC-së dhe roli i institucionit në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në administratën publike shqiptare. Në fokus të diskutimeve ishin zhvillimet dhe sfidat në fushën e administrimit të shërbimit civil, proceset e reformimit institucional, si dhe mundësitë për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe garantimit të meritokracisë.



Në vijim të bisedës u shkëmbyen pikëpamje edhe mbi modelet e administrimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit civil në të dy vendet, me interes të veçantë për proceset e rekrutimit, zhvillimin profesional të nëpunësve civilë dhe digjitalizimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në përmbyllje të takimit palët u angazhuan për të krijuar kushtet për bashkëpunim institucional dhe shkëmbim përvojash në fushën e administratës publike dhe shërbimit civil.

